




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	07.05.2012
REFERENC-Ë:	ZSP- 321/2012
PËR/ZA/TO:	" Kelkos Energy sh.p.k.", rr. e Zagrebit, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MNPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Leje të Ndërtimit - nr. protokollit 1868- ² /12 HEC Cascade Deçan



I/e nderuar,

Sipas kërkesës tuaj me nr. protokollit 1868-²/12, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi, projektin kryesor dhe dokumentacionin për leje të ndërtimit dhe ka vendosur si më poshtë në shkresën bashkangjitur

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.321/2012

Datë: 07.05.2012


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Duke u bazuar në nenin 27.4, 33, 34.2, 35.1, 37, 38, 39, 46 të Ligjit të Ndërtimit Nr. 2004/15 dhe nenin 11 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/1.-28, dhe dokumentacionit të prezantuar, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor shqyrtoi kërkesën e investitorit " Kelkos Energy sh.p.k.", rr. e Zagrebit, Prishtinë, dhe lëshoi këtë:

LEJE NDËRTIMI

- I. Investitorit, " Kelkos Energy sh.p.k.", nga Prishtina i lejohet ndërtimi për objektin ndërtimor Hidrocentrali i Vogël me kapacitet 9.2 MW HEC Belaja, në Belajë, në Pronën e Paluajtshme P-70511038-415-0, Zona Kadastrale Isniq, Komuna Deçanit, dhe për Hidrocentralin e Vogël me kapacitet 8.4 MW HEC Deçan, në Deçan, në Pronën e Paluajtshme P-70505021-165-0 dhe Pronën e Paluajtshme P-70505021-159-0, Zona Kadastrale Deçan, Komuna Deçanit.
- II. Hartimin e projektit për objektin investiv nga pika I e këtij aktvendimi e ka bërë "Kelag-Karntner Elektrizitats AG", Klagenfurt/Austria.
- III. Pjesë përcjellëse e këtij aktvendimi është edhe dokumentacioni-teknik që është marrë si bazë për lejimin e ndërtimit të objekti ndërtimor nga pika I e këtij Aktvendimi.

Faqe 2 nga 5

- IV. Leja e ndërtimit pushon së vlejtuari nëse ndërtimi nuk fillon në periudhën prej 2 vitesh nga dita e pranimit të kësaj leje.
- V. Investitori duhet që për kryerjen e punëve ndërtimore për objektin nga pika I, të sigurojë mbikëqyrjen profesionale nga personat që plotësojnë kushtet për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale të punëve ndërtimore.
- VI. Investitori më së voni deri në ditën e fillimit të ndërtimit duhet të ketë elaboratin e parcelizimit me të cilin formohet toka ndërtimore e vërtetuar nga organi i autorizuar dhe projektin zbatues.
- VII. Investitori është i obliguar që ti përmbush edhe këto obligime ligjore:
- Të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është dhënë kjo leje ndërtimi,
 - Të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Ministrie,
 - Ta lajmërojë inspektoratin ndërtimor pranë MMPH-së për ditën e fillimit të punës, së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit,
 - Pas kryerjes së punimeve, e më së voni në afatin prej 30 ditësh të paraqet kërkesën për kontrollimin teknik të objektit të përfunduar, pranë institucionit që e ka lëshuar lejen e ndërtimit (MMPH-së) në mënyrë që të pajiset me leje të përdorimit,
 - Të lejojë inspektorët të verifikojnë, gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes së ndërtimit të objektit nga pika I, për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit.



Arsyetim

Investitori " Kelkos Energy sh.p.k." nga Prishtina, në bazë të kërkesës me Nr. të protokollit 1868-2/12 të datës 18/04/2012, ka aplikuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për marrjen e lejes së ndërtimit. Aplikacionit i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:


- Provë pronësie -fletën poseduese nr. P-70511038-415-0
- Provë pronësie -fletën poseduese nr. P-70505021-159-0
- Provë pronësie -fletën poseduese nr. P-70505021-165-0
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri nr. 04/01 i datës 10.01.2012
- Vendim mbi njoftimin për autorizim preliminar lëshuar nga Z.RR.E nr. 296/2010 i datës 11.11.2010
- Lejen mjedisore lëshuar nga MMPH nr 11/445/2-ZSP -251/11
- Leja ujore lëshuar nga MMPH me nr. 1839/11-ZSP-69/2012
- Lejen urbanistike lëshuar nga MMPH Nr. ZSP-91/2012 të datës 16.02.2012
- Studimi i fizibilitetit- Lumi Deçan projekti i Hidrocentraleve
- Raporti gjcologjik dhe gjeoteknik
- Projekti kryesor (3 kopje të projektit)
- Raporti i Revidimit të Projektit Kryesor

Pas shqyrtimit të kërkesës së investitorit dhe dokumentacionit të tërësishëm të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin e Ndërtimit, Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitat tjera të ligjeve në fuqi në Kosovë, është konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore në parim për lëshimin e kësaj Leje Ndërtimore për llojin përkatës të ndërtimit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vërejtje:

Kjo leje ndërtimi hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi.

Faqe 4 nga 5



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Prishtinë**

Leja t'i dërgohen:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. DBN-së, Inspektoratit të MMPH-së,
4. Komunës së Deçanit,
5. Kabinetit të Ministrit,
6. Zyres së Sekretarit të Përgjithshëm,
7. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së

